BIBLIOTEKA
SHTETIT
8 8/1-1
H 21

Kujtim Halili

# Pranvera e pozicioneve

POEZI

8 JH-1
H 21

KUJTIM HALILI

# Pranvera e Pozicioneve

Poezi

BIBLIOTEKA E SHTETIT
63528
12654

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## DASHURIA PËR PARTINË

Gjurmët e brigadave ku nuk i gjetëm, —
në fole shqiponjash, lugjesh e qytetesh;
plagët e plumbave ku nuk i gjetëm, —
në mure, në pemë, te veteranët e thjeshtë;
dashurinë për Partinë ku nuk e gjetëm, —
në zemër të popullit thellë, thellë...
Njëherësh të shpërthejnë vullkanet e botës,
atë dashuri nuk e shkulin dot.

## NGA DISKUTIMI I NJË TORNITORI

Jeta me zhurmë tornosh na u mbush,
çdo detal djersën tonë e ka;
në damar na rrjedh heroizmi prush
dhe entusiazmi i ditëve të mëdha.

Jemi lidhur fort me metalin,
çdo tingull na josh si muzikë;
për çudi dikush mund ta marrë
kur flasim me të, si me fëmijtë.

Kështu ndërruam shtat e u rritëm
e na thonë me dashuri: «mjeshtër!», —
një sy mbi torno na e hedh dritën,
po tjetri nuk mbyllet në shënjestër.



## PRANVERA E POZICIONEVE

Pozicioneve, mbi grykat e armëve,
zgjaten kërcej të hollë luleshqerre;
nëpër thepa i hapin petalet
e flladi i dredh si zilka pranvere.

Dielli frushullon në krahë dallandyshesh,
mbi çanta shpine ulet i ngrohtë;
gjaku buçet e na shtyn në sulme
e pranvera harliset nëpër gjokse.



## AI DHE PERANDORI

Ç'fliste zemra atë çast me nagantin?
Retë shtrydhnin dhembjen mbi ballin e Dajtit.
Bryma kishte rënë në petale trëndafili
si hija e robërisë mbi qerpikët e Vasilit.
Fisheku hante folenë nga padurimi,
siç hanë brigjet rrëmbyeshëm Vjosa e Drini.
Në xhepa shtërngonte grushtet e ashpër
si të ishin mbledhur dhjetë dimra bashkë...
Dhe ecte ngadalë përmbi tokën eshkë
(tokën do ta ndiznin ato krisma rrjesht)!
Ndoshta perandori atë çast po thithte
mëngjezin erëmirë, lavdinë që e priste...
Po në sy i ngrinë malet e larta,
malet majëzhveshur, malet si shpata.
Dora e Vasilit negantin ia ktheu
(njeherësh shpatat sikur vërshëllyen).
Dhe rënkoi poshtë frikës. «Ah, popull i sertë!», —
populli nuk njihte perandor as mbret.

## SHYQYRI ISHMIT

Era, që zbriste me zhurmë nga Dajti,
«Malet me blerim mbuluar» fishkëlleu;
mbi ankthin e fashistëve tundej litari
dhe buzëqeshja e Shyqyriut.

Blerimi i së ardhmes ai ishte
si Qemali, Mistua e Vojua mbi tank,
si kolonat pa mbarim të rinisë
në tokën plumb e në qiellin flakë.

Mbi gjoks thikat gjak i pikonin,
por ballin nuk ia uli asnjëherë dhembjes, —
fashistët në hapat e tij dëgjonin
ortekun e lirisë dhe çastin e rënjes.

Ai tej i shtyn me brrylat e hakmarrjes
e krenar shkon përballë litarit
siç shkoi dhe në rrugën e madhe
ku shtoheshin rreshtat si në livadhe bari.

## MBRËMJA E FUNDIT KUR DO TË SHKOJ USHTAR

Nëna ze brumin me grurë të ri
e rigoni në mur kundërmon;
nga shpirti më ikën fëminia
e një ndjenjë e re më burrëron.

Nën dritare më janë mbledhur yjet,
burimet, shtigjet, kopetë me dhen;
fqinja mblodhi lule nëpër pyje
lamtumirën sonte për të më dhënë.

Më thërrasin zogjtë nga foletë: «U rrite!»,
plakat bisedën tjerrin për një nuse;
kokë më kokë u mblodhën edhe vitet
të më shohin ushtar me pushkë.

## USHTARI ME FYELL

Në stolin e kaltër kur ulet
nga fyelli dalin rrëke e bien këmborë;
vajza me gërsheta mbledh lule,
një tufëz në letër atij t'ia dërgojë.
Vrulle ndjenjash i lëshon gjoksi:
shkëmbinj me gërxhe e thellënxa,
fërfëllojnë në dallgë jonxhe kosat,
rreth mullarëve vallen hedh hëna.

## USHTARËT E RINJ

Grason u fshijnë karikatorëve
e përsëritin detyrat në vendroje,
era e gëlqeres trazohet
me erë trëndëline e molle.

I kujtojnë nënat në udhë
kur xhepat me fruta ua mbushën...
shamitë i ngritën nënat e urta
e në faqet me push i puthën.



## BORIZANI I BRIGADËS I S.

Nëpër dallgë sulmesh
nxjerr tinguj stuhi
borizoni Haki.
Nga zemra në zemër,
nga shkëmbi në shkëmb,
nën shiun me krisma
me plumba të rëndë;
mbi korie flakësh,
hekur e gjermanë,
seç gjëmon boria:
«Para, partizanë!»
Fyti i rrjedh gjak,
gjaku mbi dëborë,
borinë ngroh trimi



thellë në kraharor...
Pëllëmbën në plagë,
buzët në bori
partizani Haki.
Me vrull në betejë
tingujt i shpërndan:
«Para, partizanë!»

**MARGARITËS**

Mbi qerpikë bulëza
gjaku të pikoi,
Margaritë, moj.
Një grusht me dhe
e mbaje në zemër
si më të bukur ëndërr
Nëpër flokë lule,
lule e gëzhoja
sa desha të zgjoja;
të shkoje sërish
nga porta në portë, —
si kushtrim lirie
zëri yt i ngrohtë.

Dorën me zinxhira
nga Kristaqi ngritur...
por plumbi s'kish pritur.
Dy rrëkeza të kuqe
zgjaten nëpër vite,
dy burime drite...

## LUFTIMET E SHEMBËRDHENJIT

Ç'janë ato yje, maleve shkëlqejnë,
ky tufan këngësh përmbi Shembërdhenj?..
Po pëlcasin bomba, tinguj po pëlcasin
atje, shokë, zemrat «hakmarrje!» thërrasin.
Përmbi gryka topash nata po varet
e grirë nga plumbat, e djegur nga zjarret.
Ç'janë ato yje, lart mbi male, ç'janë?
Në vend të fishekut kënga mbush gjerdanë.
Shkëmbenjëve armiqtë stepin edhe ngrijnë,
kolonat tërhiqen qafash si gjarprinj.
Shembërdhenj i gurtë, o skenë vigane,
ku shpërthen tufani i këngës partizane.

## MIHAL DURI

I shpërthente guximi dhe ishte i fortë si guri
lulja e trimave Mihal Duri.
Erzeni rridhte gjak e vala shtynte valën,
ai si bombë e pëlciste fjalën.

Kur mbrëmjeve, pranë zjarrit, ulej në vatër
në buzë i çelte agimi i afërt;
pushkën s'e ndante nga supi, zemrën nga Partia
Mihal Duri me sytë shkëndija.
Shpatullat e hekurta mbi armiqtë i vuri
lulja e trimave Mihal Duri.
Kush tha se ra nga plumbi i pabesë?!
Zjarrin e Partisë vatrave ai ndez.

## BAGËTI E BUJQËSI

Kapakët të rëndë, të rëndë sa malet
e fletët fëshfërijnë si korije.
Mendja e poetit fluturon e s'ndalet,
pas xhurasë mbledh kopetë me zile.

Ai rri shpirtgjelbër përmbi shkëmb.
Pena i pikon gjak e gjaku lule, —
malli si qiri i digjet në zemër
kur shpatën e fisit mpreh për sulme.

Në mushkëri nuk thith tym mejhanesh
e trëndafila haremesh vargjet nuk i nxjerr,
gjoksin e ve në tokë e toka shfryn tufane
e në tufane mbijnë lule vere.

## VDEKJA E SULLTAN MURATIT

Sulltan Murati nuk vdiq se piu helm,
po nga marazi gjaku helm i rodhi, —
buzë shatrivanit, pranë haremit,
Skënderbeu si fantazëm i doli.

Skënderbeu mbi kokat e pashallarëve të tij,
armët e rënda ngjeshur e ballin kështjellë;
mbi gjoks i flakëronte një shkëndi,
një shqiponjë mbi gjoksin e gjerë...

Çallma i ra në qilimin nga Persia.
Duart me brilante nga arbëri i ktheu, —
në zemër si mace iu mblodh perandoria
e vdekja iu ngul si shpata e Skënderbeut.

BIBLIOTEKA E SHTETIT GJIROKASTËR
Nr. 63528

## ARBËRESHËT

Brigjeve endeshin ball'vrenjtur, —
midis brigjesh deti i kaltër i mallit.
Vetë ishin këtej, andej gjaku, zemra,
varret e shokëve, hasmi i arbërit.

Plagët u kullonin mbi flamur,
armët në trup u kishin mbirë;
horizonti i dallgëve hapej i purpurt
dhe hëna i ftonte betejash, si bri...

Tundnin djepet në kështjella këngësh
gratë e thinjura nga borë e trishtimit,
fëmijët pinin me qumështin e nënave
dashurinë për atdhe dhe bekimin.

## KËNGËT HIMARJOTE

Tingujt kanë dritë, tingujt kanë barot,
nëpër degë limonash mbështeten, —
e mbi krela trimash të përgjakura lot
porsi dorë nëne, era e detit.

Tingujt kanë stërkala, tingujt kanë prush, —
dallgë isosh mbështjellin shkëmbenjtë
dhe udhët e zemrave i mbush
gjaku i dëshmorëve rrëke. . .

## USHTARËVE TË PARË

Ata ikën në mëngjeze vjeshte...
Rreshtat i mbushën të tjerë,
që përcollën krisma të rrepta
dhe pozicionet i hapën më thellë.

Po në zemër më buis dashuria
e në mëndje më hapet një shteg, —
varg në kujtimet e mia
ata hyjnë të qeshur e të thjeshtë.

## BISEDA E PARË ME USHTARËT

Zëri sot i ndrojtur në më del,
ushtarë të dashur, mos u shqetësoni.
Tok do të çajmë në mjegull e në erë,
dhe mirë do të na njohë pozicioni.
Tok do t'u vemë gjokset frëngjive,
shokët në sulm më tej të kalojnë, —
ushtarët janë zogj të stuhive
dhe ëndrat në stuhi u lulëzojnë.
Një kapotë do t'na mjaftojë të gjithëve
dhe dashuria për shokun në acar,
ndaj kur të largohemi pas viteve
për njëri tjetrin malli do të na marrë.

## KËTU

Këtu gulçon traktori nëpër plisa
dhe uji çdo rrënjë e njom,
djersa në qepalla të mpikset
e gjoksi të mbushet aromë.

Në çdo pore të trupit hyn dielli
hovet rinore i ndez
dhe kallëzat lehtë përkëdhelen
në sytë e mëngjezeve që qeshin.

Gufojnë ugaret nga shpërthimi
e bimët përkunden nga puhitë;
pushkët e çetës, kulmuar në brinjë,
tytat i mbajnë mbi kaltërsi përditë.

## UDHËT E FËMINISË

Udhë të fëminisë me korie e bilbila,
zbathur shkelëm baltën tuaj, gropat, vijat
me një copë bukë misri të verdhë në çantë,
kur atdheu kapërdinte të parën kafshatë.

Me një libër fshehur nga shiu në gji,
e holla, e dridhura, e kaltëra fëmini.
Ecnim mbi ju me këmbë të vrara, të ngrira,
o udhë ëndrrash të dashura e ëndrrash të mira.

Andej u nisëm e çamë nëpër jetë
dhe ju tok me ne u rritët aq shpejt.

Mbi asfaltin tuaj e zgjatim hapin sërish tani
dhe na pëlqen t'ju kujtojmë si dikur në fëmini.

## NET FSHATARE

Mbi dritaren time bien netët
posi lule të verdha nga livadhet;
mbi pëllëmbë kokën e mbështes,
e ballin ma përkëdhelin flladet.

Në gjoks më gurgullojnë ujërat,
nga parcelat e buta tek vijnë;
bimët si në ëndërr po zgjohen
e kërcejtë nga freskia i shtrijnë.

Vesa i njomi mullarët,
zogjtë u tulatën më thellë;
hëna nëpër pjergulla po varet
e kuajt hingëllijnë në lëmenjtë.

Mbi dritaren time ulen netët
e gjumi nuk dashka të më marrë;
netët bien erë çaji e thekre,
mbështjellin me ngrohtësi ugarë.

## NË FESTIVAL

Djemtë dolën nga vetëtima malesh,
vajzat nga agimet ngjyrë alle;
u drodhën, u hapën si petale vallet,
bubullojnë daullet, daullet mënd çahen.

Sytë digjen prush e ndizen shamitë,
zemrat njëra tjetrës i bëjnë pritë;
djemtë e vajzat vijnë rreth e rreth, —
në flokët e tyre pranvera si gjeth.

Në buzët e tyre, tinguj fyejsh e cyrlash,
gurgullima krojesh, ligjërime bilbilash...

## ATYRE QË SHKUAN NE SPANJË

Kur vapori çante në Mesdhe
zemrash ju shfrynte mall' i brigjeve
e vështronit malet me kokë në re.
Në xhepa shtërngonit një grusht dhe...
Tej, pas dallgëve, tymi i luftës tirrej
brigjesh me ullinj të Spanjës martire...
Populli ju përcolli, ju o lule trimash, —
në palcë të fashizmit zjarre vetëtimash.
Nën palë flamuri, gjakut si rrëke,
zemrash u frynte mall' i brigjeve.
Si malet shqiptare me kokë në re,
lavdisë së luftës, ju mbetet atje...

## LULKUQET

Ku nuk mbinë, ku nuk mbinë lulkuqet;
në zemra, shkëmbenjëve, lugjesh.
Vajzat qëndisnin në gjergjef çdo natë
shqiponja me krahët shtrirë në gjak.
Mbi palët e kuqe të flamurit arbëror
burrat lidhnin besën e zemrat barot.
E kur në sulme si lisat ranë,
rrahjet e zemrave atdheut ia dhanë.
Kokë më kokë si malet ngritën këngë lufte,
në këngë binin trima, çelnin lulkuqe...

## MIQËSIA PARTIZANE

Ne e ndanim një kulaç me hi
dy shokë, një çetë a kompani
e, kur pushonim me ballet mbi pushkë,
me rradhë pinim cigaren me fletë dushku.

Fishekët e bombat i ndamë pas përpjekjesh,
mbi një gur mësuam si hiqet këmbëza e shkrepjes
e kur mes borës e plumbave shokët ranë
ne i tërhoqëm, armikut kurrë s'ia lamë.
Nuk e çanë dot rrufetë, nuk e thyen tufanet,
miqësinë e zemrave, e zemrave partizane.

## KAFSHARËT

Pëllëmbët i shkojnë ngadalë
në jelet e dirsura të kuajve,
(Kuajve gjokseve u ngrin shkumba e bardhë
dhe vaji i mortajave).

Përplasjen e patkonjëve pas gurëve
e njohin aq mirë tani,
në pëllëmbë ujin e pagureve
e hedhin që kuajt të pijnë.

Kuajt sytë i mbajnë andej,
në heshtje përtypen të menduar;
në gjokse lehtë u përkëdhelen
kafsharëve të lodhur, të gëzuar.

## KUR LAJMË

Nëpër fletë e gurë shushuron përroi,
ne freski thithim e biem në gjunjë.
Valët e buta pecet na i njomin,
gjer në brryla na gufohet shkuma.
Sytë e nënave, motrave, të dashurave
na shfaqen të kaltëra në rrjedhë,
pëllëmbët nga fërkimi skuqen flakë,
qerpikët rrahin si krahë zogu në erë...

## SHTEGU I ËNDRRËS

Kokën e vemë në jastekë pas rojes,
(era pemët i kërrus gjer në tokë)
qepallat më mbyllen nga lodhja
nga fryma e shokëve e ngrohtë.

Një shteg ëndrre gjej për te ti,—
me ballin nga rruga pret, o nënë,
asnjë çast s'më braktise në detyrë
dhe në pozicion me mua hoqe këmbëzën.

## BETIMI

Kjo tavolinë me cohë të kuqe mbuluar,
kjo listë e thjeshtë me firma përbri;
mëngjezi hedh buqeta rrezesh i gëzuar
e numrat e armëve në buzë na mbijnë.

Në gjokse Republika merr frymë,
si pranverë e kuqe gurgullon në damarë, —
betohemi, e betimi si himn
shpaloset mbi rreshtat ushtare.

Komisarëve thinja betejash u ndrijnë,
grushte kujtimesh ngrejnë mbi balle,
në zemra na i hedhin si shkëndija
nga dashuria e tyre e madhe.

Tufani i zemrave hapet i gjelbër,
pylli i bajonetave na lëkundet në brinjë
e çdo gërmë e formulës shpërthen si predhë
mbi armiq të vjetër e të rinj.

## V. F. L.P.

Katër gërma gjaku gdhendur nëpër mure,
thellë zemrave gdhendur.
Vatrave të thjeshta tek hynin e dilnin,
buzëve na lanë rrezet e agimit.
Eh ç'gjëmuan fort nëpër udhë llogoresh
katër yje gjaku në ballë të fitores.
Në qiellin e luftës një dorë i ndizte,
dora e Partisë Komuniste.

## KUR DËGJOJMË KOMISARIN

Ne shkojmë pas komisarit në ato vite
nëpër gropa e tela, në tymin e rëndë;
nga bunkerët vdekja na zë pritë
e gjakun fshijmë nga ballet me mëngë.

Ngrihen me radhë trimat e brigadës
Fejziu, Karadaku, Gjoka e Neta...
pylli i historisë lëkundet i zjarrtë,
lëkundet plumbave të rreptë.

Ne shkojmë me komisarin n'ato vite
e vijmë përsëri të ngarkuar
me lavdinë e tyre, rreze gjaku e drite,
betimin e kuq brezave për t'u çuar.

## USHTARËT DHE KOMANDANTI

Ushtarët zbritën nga tanket
qerpikët dhembja ua lagte;
erdhën e zemrat ia hodhën si hymn
komandantit Lym...

Ai u ngrit si dielli mbi livadh
tek fliste thjeshtë për çdo bisedë e hall
e me ushtarin edhe zemrën e ndante, —
zemrën shkëmb në sulm' e atentate.

Atyre djersë u kullojnë xhaketat,
pas stërvitjes u buzëqesh Lym Keta...
Tankistët u kthyen e tanket ngan' me vrull,
ai në këmbë qëndronte mbi çdo kullë...

## KUJDESTARIT VETERAN

Ai veshi breza ushtarësh....
Zërin ua njeh dhe emrat ua di;
tok me ta qeshi e u trishtua
i priti edhe pas stërvitjes në shi.

Teshat ua teri e këpucët ua ndërroi.
Ndoshta mbrëmjeve i qortoi pak rreptë,
po pas vitesh të gjithë e kujtojnë, —
kujtimet, si një kurorë e blertë.

Po ta kërkosh e gjen nëpër rreshta
e në grusht yje të zjarrtë mban;
bustinat i ndez nëpër vjeshta
kujdestari, flokëthinjuri veteran.

## TË DJELËN

E djela hapi krahët
mbi rrugët e garnizonit e maja malesh.
Buzë stolash po qepin qaforet
ushtarët e radhës për liri dalje.

Altoparlanti, si shpend i bardhë mbi drurë,
derdh melodi të gjelbra popullore.
Me komanda të prera mbushin
armët ndrresat pranë truprojes.

Midis zhurmave e zërave dallojmë
tingujt e borisë për rreshtim,
e djela mbi supet na shkund
mijëra shkëndija gëzimi.



## HAJDE

Hajde të vemi në kroje,
gërshetat t'i çthur më lërë;
në buzët e çelura si hoje,
freskia të humbë e tërë...
Hajde të vemi nën mollë,
fluturzat e luleve të kapim;
në vetullën tënde të hollë
mëngjezi krahët t'i hapi.
Hajde të marrim pushkët e vajisura,
shulet t'i tërheqim me gishtrinj;
gëzimi të na shpërthejnë me krisma,
armikun ta zërë brinjë më brinjë.

## NDARJE USHTARËSH

Mbështetur spondeve të drunjtë
grushtet tek dielli i ngrejnë lart,
t'ia u ulin topave mbi gryka,
të lënë diçka të shtrenjtë te ky repart.

E kanë vështirë të ndajnë zemrat sot,
komandanti s'i lidhka dot dy fjalë, —
dashuria i shtrika rrënjët fort
këtu në pozicion, në vijë të parë.

## GJERGJ ELEZ ALIA

Nëntë plagë në shtat, nëntë kroje trimërie.
Mbi to motra rri.
Nga legjenda, në udhë çiftelie,
zbret mbi at, o Gjergj Elez Ali.

Ti kalon me fytyrë nga deti,
ballin e ngre atje në shesh-mejdan;
motra me lotë e njomi gërshetin,
mbi shtratin e viteve tek qan.

Qielli shkarkon rrufe e deti çahet,
balozi atin e vdekjes nget;
topuzi yt i skuqur prej plagëve
e rrëzon poshtë e toka ndjen tërmet.

## FUNDI I BALLABAN PASHËS

Në çadrën e ylbertë e rrobet gjithë prarim
shkëlqimi i tradhëtisë e verbonte.
Në gjunjë i fërkoheshin vajza si agime,
e hordhitë nxinin tej në horizonte.

Në gishta i vareshin tespie fildishi,
në vetulla urrejtja për fisin shtrirë;
mbi bedena arbërit e prisnin,
arbërit me shpata lavdinë ia kishin grirë.

Pikoi çdo fije bari gjak,
pëlcitën nga mallkimi dhe gurët, —
po mbi dallgë hordhish u ngritën prap
shqiponjat dhe flamurët.

Në sytë e hirtë i përdridhej një meshollë
e shatrivane tingujsh rreth i vinin...
Sulltani priste mes ankthit në Stamboll
kokën e prerë të kryetrimit.

Gulçima çau qiellin: «allah!»,
kali arab u drodh e hingëlliu;
hënzën puthi e toka lëshoi zjarr
e mes rrëmujës: «yrysh!» sokëlliu.

Po krahu iu pre e drita i shteri
e koka i ra në këmbët e kalit,
hordhia iu shua e çadra si ylberi
dhe mjekra e thinjur nga turpi e Sulltani.

Dhe mbeti i patretur në truallin e atdheut
me flamurin e zi të tradhëtisë mbështjellë
kur luftëtarët brohorisnin e Skënderbeu,
verbonte armiqtë si yll mbi keshtjellë.



## SHOTËS

Rrok lahutën, Shotë,
bjeri përmallueshëm
se malet e lartë
me trima u mbushën.
Zëri yt i fortë,
zëri yt i pastër,
lëshohet me hov,
kushtrim në çdo vatër.
Shtrihet nëpër gryka,
hapet nëpër lugje,
burrat lidhur kokën
me shami të kuqe;
burrat lidhur besën;
lidhur zemrat trime,
armët i shtërngojnë
gati për luftime.
Kanë mbështetur shpatullat
rëndë mbi shkëmbenj,

kënga tingullzjarrtë
të tërë i rrëmben.
I ndez kënga, Shotë,
në sulme kur hidhen, —
ndaj këndo më fort,
telat le të dridhen.
Kur armiqtë sulmojnë
kënga shkrep rrufe,
kur i marrin plumbat
në këmbë i ngre.
Rroke ti lahutën,
rroke pushkën, Shotë,
malet tej për tej
mjegull e barot.
Gjaku njomi tokën,
u derdh në rrëkera, —
ç'u ngjite në çetë
e shpejtë si era.
Shpërthyen nga zemra,
tej e mban' Kosovës,
këngët e fuqishme,
këngët e fitores.
Ndaj rroke lahutën,
bjeri për lirinë,
të dëgjojnë, Shotë,
brezat që do vijnë.

## ELEKTRIFIKIMI I VENDLINDJES

Drita më nuk thyhet
mbrëmjeve të thella,
majëmalet zgjaten
si gishta mbi tela.
Zemrat ndizen prush
nga tinguj e rreze,
dashuritë tona
çelin në mëngjeze.
Gëzimi na rritet
si rrethi në valle,
shpalosen buzëqeshjet
të bardha si shalle, —
pejzazhi i vendlindjes
në syt' e mi ulet,
përthyer nga llampat,
nga zogjtë dhe lulet...
Zhurm' e traktorëve
kaltërsinë dredh...

buzët e taracave
me avuj mbështjellë.
Ndaj pushkën shtërngoj
unë ushtari në radhë
që vendlindja të mbetet e
ndritur, e bardhë.

## KËNGËTARES POPULLORE

### FITNETE REXHA

Në zërin tënd tundet një degëz qershi,
një burim ka, ku trimat buzët vënë,
një zemër plot dritë e ngrohtësi
e si dajre mbi ballë një hënë.

Hodhe sa ylberë mbi kraharorë
me këngë popullore ngarkuar,
kurrë s'të heshti zëri; s'të shteroi
nëpër vite duke gurgulluar.

## Ç'NA DHANË NËNAT

Nënat na dhanë fytyrat e rrepta të maleve,
flokët e arta si grunjërat në arë,
shpirtin të pastër si gurra kristali,
syrin e shqiponjës dhe urrejtjen strall.

## ATDHEU

Atdheun e gjejmë dhe në një pikë vesë,
në një copëz shkëmb a kaltërsi, —
Atdheu është gjithshka që s'vdes,
se në gjak të rënësh rrënjët shtrin.

## PORTRETI I NËNËS

Duke shkuar në vendroje,

mes qiellit, në mëngjezin e pastër,

m'u shfaq portreti i nënës.

Zgjata bajonetën dhe preva kornizën e kaltër

për ta vendosur portretin pranë zemrës.

## DËSHMORES AKSIONISTE ADELINA GJONI

Ishte një vajzë atje, ku gurët rrëzoheshin,
rruga si fjongo dridhej nëpër mina.
Shkëndija baromine në sy i vezullonin,
aksionistes së vogël, Adelina.

Binin pellgjeve të përroit gjethe e fletë.
Buzëve i çelte kënga vajzës nga uzina, —
mbi qepalla gjumi na ulej lehtë
me zërin e të bukurës Adelina.

Rruga çan nëpër gjurma gjaku,
shokët ushtarë në kujtimin tënd rrijnë,
e të thërrasin, të thërrasin së largu:
Adelinë, motërzë, Adelinë

*

* *

Kur shokët ngritën duart
të më pranonin në parti,
në atë pyll të gjelbër e të lartë
unë isha një filiz i ri.

Kur sekretari teserën më dha
në firmë kishte çelur agimi, —
përshëndetjet e shokëve më rrëmbyen si
dallgë
e dallgët më rritën guximin.

## PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Dashuria për Partinë . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 3
Nga diskutimi i një tornitori . . . . . . . . . . . . . . . . . 4
Pranvera e pozicioneve . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 5
Ai dhe perandori . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 6
Shyqyri Ishmit . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 7
Mbrëmja e fundit kur do të shkoj ushtar . . . . . . . . . 8
Ushtari me fyell . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 9
Ushtarët e rinj . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 10
Borizani i Brigadës I S. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 11
Margaritës . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 13
Luftimet e Shembërdhenjit . . . . . . . . . . . . . . . . . 14
Mihal Duri . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 15
Bagëti e bujqësi . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 16
Vdekja e Sulltan Muratit . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 17
Arbëreshët . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 18
Këngët himarjote . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 19
Ushtarëve të parë . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 20
Biseda e parë me ushtarët . . . . . . . . . . . . . . . . . . 21
Këtu . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 22
Udhët e fëminisë . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 23
Net fshatare . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 24
Në festival . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 25

Faqe


Atyre që shkuan në Spanjë .................... 26
Lulkuqet .................... 27
Miqësia partizane .................... 28
Kafsharët .................... 29
Kur lajmë .................... 30
Shtegu i ëndrrës .................... 31
Betimi .................... 32
V.F. L.P. .................... 33
Kur dëgjojmë komisarin .................... 34
Ushtarët dhe komandanti .................... 35
Kujdestarit veteran .................... 36
Të djelën .................... 37
Hajde .................... 38
Ndarje ushtarësh .................... 39
Gjergj Elez Alia .................... 40
Fundi i Ballaban Pashës .................... 41
Shotës .................... 43
Elektrifikimi i vendlindjes .................... 45
Këngëtares popullore Fitnete Rexha .................... 47
Çna dhanë nënat .................... 48
Atdheu .................... 49
Portreti i nënës .................... 50
Dëshmores aksioniste Adelina Gjoni .................... 51

Redaktor: *Ramazan Vozga*

Piktor: *Qamil Prizreni*

Tirazhi 1.500 kopje  Format 70x100/32  Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974